



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 06.06.2023, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi miratimin e kërkesës së AAES për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 23, datë 14.02.2022, “Mbi miratimin e rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit”.
2. Mbi licencimin e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
3. Mbi licencimin e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.
4. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 198, datë 03.09.2018.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 245, datë 26.11.2018.
6. Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k., për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguroese) të aseteve të paluajtshme të centralit fotovoltaik Blue 1 në favor të Green for Growth Fund Southeast Europe s.a, SICAV-SIF.
7. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s, më datë 29.05.2023.